



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" REKTORI

Qendra Kërkimore Shkencore për Kërkime dhe Zhvillime në Drejtësi dhe Ekonomi, në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Elbasanit "Aleksander Xhuvani", shpall konkurs për pozicionin e punës 1 (një) personel akademik me kohë të plotë, i kategorisë asistent lektor

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme e të veçanta:

Kritere të përgjithshme:

1. Të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalente me të në fushën e drejtësisë. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njësuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri)
2. Të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalente me të në fushën e drejtësisë, me notë mesatare mbi 8.0.
3. Të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të Bashkimit Europian.
4. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi të largimit nga puna.
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Kandidati duhet të zotërojë këto kritere të veçanta.

1. Të ketë përvojë në të punuarit me projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare si edhe në punë kërkimore;
2. Të ketë përvojë profesionale në fushën e drejtësisë;
3. Të ketë përvojë pune në IAL të paktën 2(dy) vite;
4. Pjesëmarrje në konferenca shkencore dhe publikim të artikujve shkencorë të botuar në revista shkencore ose Proceedings Books.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" brenda 10 (dhjetë) ditëve (**14.11.2022 - 23.11.2022**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Formular aplikimi;
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Kopje e noterizuar e diplomave dhe të listave të notave. (Diplomat e lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njësuar nga Minsitria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- Dokumentacion shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar sipas plotësisimit të kritereve të shpallura;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës/Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës;
- Çertifikata, kualifikime, brenda dhe jashtë vendit, të njehsuara me origjinalin;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Raport i gjendjes shëndetësore, që vërteton aftësinë për punë;
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Librezë shëndetësore

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (14.11.2022 - 23.11.2022)

nga data e shpalljes në www.app.gov.al në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: *asistent lektor në FE*
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit Ekonomik. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do të nënshtrohen intervistës me gojë (28.11.2022 – 09.12.2022). Kandidatët konkures do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.